**E K S T R A K T**
**i procesverbalit të diskutimit publik me qytetarë, mbajtur më 12.4.2023, duke filluar në orën 12:00.**

**Në diskutim publik morën pjesë:** Osman Bllaca, Lindita Rexhepi, asambliste, Sokol Havolli, kryeshef i ndërmarrjes "Prishtina Parking", Artan Mullarama, përfaqësuese e ndërmarrjes "Prishtina Parking", Sami Salihu, asamblist, Jahë Balaj, qytetar, Besnik Vitija, qytetar, Donika Ahmetaj, shoqëria civile, Imer Rama, qytetar, Ismail Jakupi, qytetar, Agnesa Sahiti, gazetare, Jeta Rafuna, asamblistë, Shaip Dushi, qytetar dhe Granit Prestreshi, qytetar dhe Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspekcionit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, duke ju uruar të pranishmëve mirëseardhje  në takimin me qytetar.
Në vazhdim ai tha se për këtë takim është paraparë ky

**REND I DITËS:**

1. **Diskutim publik lidhur  me Projektrregullorën për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së  Prishtinës**

**Osman Bllaca,** hapi diskutimin

**Florian Dushi,** drejtor lidhur me Projektrregullorën për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së  Prishtinës, tha se ne si drejtori jemi ballafaquar me numër të madh të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve që ndërlidheshin me shtrirjen ose zbatimin e projektit të ''Prishtina Parking'' në Kryeqytet, kështu që duke pasur parasysh gjendjen e krijuar është themeluar një grup punues i cili ka punuar mjaftë gjatë dhe ka analizuar në hollësi të gjitha aspektet e kësaj rregulloreje janë analizuar, janë vlerësuar madje edhe një pjesë e tyre janë përfshirë në këtë draft.
Janë rregulluar mjaftë shumë çështje të cilat kanë qenë të pazgjidhura me draft rregulloren, janë rregulluar mjaftë shumë çështje të cilat kanë lënë hapësirë për interpretime të ndryshme me drafte rregulloren e vjetër ose atë që është në fuqi sot.
Për veç bazës ligjore që kishte për të trajtuar ankesat e qytetarëve me Rregulloren e cila është në fuqi, ishte e autorizuar edhe të e mbikëqyrë implementimin ose shtrirjen e Ndërmarrjes ''Prishtina_Parking''.
Me këtë rregullore  mund të vendoset rend, mund të vendoset rregull në kuptimin e menaxhimit të hapësirave të dedikuara për parkimin e veturave qoftë të banorëve rezident ose të atyre që frekuentojnë zona të ndryshme të Kryeqytetit për punët e tyre, kështu që ne

mendojmë që edhe me komentet, sugjerimet dhe idetë e juaja, të cilat do të kemi mundësi t'i dëgjojmë gjatë këtyre ditëve që do ta kemi edhe organizimin e këtyre debateve publike që ndërlidhen me këtë Rregullore, qoftë nga ana e qytetarëve, bizneseve apo edhe përfaqësuesve të zgjedhur të popullit që janë pjesë e Asamblesë Komunale të Prishtinës.
Çmimorja për të gjitha parkingjet do të caktohet nga Kuvendi Komunal i Kryeqyteti.
Menaxhimi dhe klasifikimi i zonave të vendparkimeve publike, hapësira me ngjyrë të kaltër, është e përcaktuar për banor vetëm me leje të vlefshme parkimi të cilët parapaguajnë dhe mund të parkohen në zonën me ngjyrë të kaltër, personat e tjerë mund të përdorin këto parkime vetëm deri në orën 16:00.
Si grup punues, me përfundimin e dëgjimit të debateve me qytetarë, ku do t'i trajtojmë secilën veç e veç, për të parë nëse ka hapësirë të përfshihen në këtë draft Rregullore.

**Sokol Havolli,** kryeshef tha se kjo rregullore në masë të madhe adreson një ndër problemet kryesore me të cilat është ballafaquar qyteti dhe që ka të bëjë me menaxhimin e hapësirave të banorëve rezident.
Një pjesë mjaftë problematike prej këndvështrimit të qytetarëve ka qenë pikërisht çështja e zonave rezidenciale, tani më kjo rregullore me vendosjen e kufizimeve në afatet kohore lidhur me mundësin e parkimit të vizitorëve në lagjet rezidente veç e krijon hapësirën e mjaftueshme për banorë rezident, sepse si ndërmarrje përgjatë 5-6 muajve të kaluar kemi bërë analiza të detajuara lidhur me frekuentimin e automjeteve në zonat rezidenciale pothuajse në çdo lagje të qytetit dhe nënlagje të qytetit.
Me këtë rregullore do të bëhet vendosja e kufizimit kohor që pas orës 16:00 hapësirat të mbesin në shfrytëzim vetëm për banorët rezident dhe me këtë mendoj se do të e zgjidhim çështjen e problemit për paring të banorëve rezidente e që këto kufizime do të vendosen përmes tabelave vertikale ku njoftohen të gjithë vizitorët potencial se parkingjet brenda lagjes pas orës 16:00 janë të ndaluara për vizitor dhe janë vetëm në shërbim të banorëve rezident.
Konsideroi se kjo rregullore e ka një orientim të jashtëzakonshëm në drejtimin e zgjidhjes së problemit për banorët rezident.

**Sami Salihu,** tha se është e mirëseardhur kjo rregullore, por kërkoi nga kryeshefi i ndërmarrjes të dijë se, a është e paraparë ndonjë leje ku qytetarët apo ndonjë biznes mund të paguaj ndonjë shumë të konsiderueshme por që mund të parkojë automjetin kur të do dhe ku të do.

**Florian Dushi,** drejtor, tha se nuk është ngritur ndonjë ide që të kemi një pagesë, një dokument ose një leje pastaj qytetari mund të parkohet kudo në Prishtinë megjithatë kjo mund të mbetet është menduar për rezervimin e disa hapësirave që më tepër ndërlidhen me disa institucione të rëndësishme, institucione ndërkombëtare diplomatike etj.
Po ashtu edhe për vendosjen e kamerave janë vendosur disa kritere sipas të cilave ose të cilat vlejnë praktikisht për parkingjet private por në njëfarë forme do të duhej të njëjtave tu nënshtrohen edhe parkingjet publike.
Më pas shtoi së vendparkingjet privat dhe "Prishtina Parking", duhet t'i plotësojnë këto kritere:

1. Certifikata e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;
2. Marrëveshja apo kontratë e noterizuar me pronarin e ligjshëm për shfrytëzimin e hapësirës së caktuar si vendparkim;
3. Projektin për kyçje dhe funksione të hapësirës së vendparkimit i hartuar nga inxhinieri i komunikacionit rrugor;
4. Hapësira për vendparkim të ketë së paku 10 vendparkime;
5. Kyçja të mos lejohet në rrugë e cila ka më tepër se dy shirita për kaheje të njëjtë;

6. Parkingu duhet të ketë qasje direkte në rrugë dhe jo të kaloj përmes trotuarit, të ketë shenjëzim horizontal dhe vertikal;
7. Shtrimi të jetë me kubëza asfalt, të ketë sistemin e kamerave.

**Sokol Havolli,** kryeshef lidhur me çështjen e ngritura nga z. Salihu, tha së ne në ndërmarrje i kemi bërë disa analiza të cilat do të i prezantohen grupit punues por edhe Kuvendit Komunal, lidhur me çështjen e pagesës mujore për zonat komerciale, ku dhe do të ketë një çmim të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.

**Besnik Vitija,** qytetar tha se ne si banor të lagjes "Bregu i Diellit", kemi propozuar që banorët rezident për veturën e parë të lirohen nga pagesa dhe mendojmë që është një kosto e lartë që për një parking të paguajmë 5 euro, është çmim i papërballueshëm, por problemi kryesor është së hapësira para banesave aty ku jetojmë nuk ka vend të mjaftueshëm për banorët rezident.
Pra kërkojmë të mos bëjmë pagesa, ndërsa kur të e shfrytëzojmë parkingun në lagjet e tjera të paguajmë me plotë dëshirë, sepse e shfrytëzojmë një lagje tjetër, një hapësirë tjetër.

**Florian Dushi,** drejtor tha se "Prishtina Parking", tashmë ka përvojat e veta sa i përket menaxhimit të mungesave të hapësirave që shfaqen kur i krahasojmë me numrin e njësive banesore në zona të caktuara, prandaj sigurisht këta e kanë edhe idenë se si do ta zgjidhin këtë çështje.
Për ne ka qenë e rëndësishme që të krijohen hapësira, sepse natyrisht në fillimin e zbatimit të kësaj rregulloreje banorët kanë kërkuar që fare mos të ketë një rregullim të tillë, mos të ketë një ndërmarrje të tillë, të jetë gjithçka e lirë në kuptimin e parkimit.

**Sokol Havolli,** kryeshef tha se ne kemi filluar zhvillimin e disa projekteve edhe për pjesën e "Bregut të Diellit", por edhe për lagjet tjera, kryesisht duke e përfshirë edhe rrugën "Fadil Ferati".
Vlerësimi ynë si ndërmarrje është se mbi 90%, të problemeve brenda lagjes janë të zgjidhshme, janë 2-3 rrugë në të gjithë "Bregun e Diellit", ku problemi është më i theksuar, mirëpo tek rruga "Fadil Ferati", numri i automjeteve të banorëve rezident, në raport me hapësirat për parkim është përafërsisht i ngjashëm. Ka nevojë për disa ndërhyrje infrastrukturore të vogla që të bëhet trotuari në njërën anë, ndërsa në pjesën tjetër të zgjerohet pak rruga në kosto të trotuarit, pa e humbë trotuarin.

**Shaip Dushi,** qytetar tha se a ka Komuna ndonjë plan që të ndërmarrë ndonjë veprim për auto veturat që janë të parkuara dhe që i ka mbuluar pluhuri, me gomat e shpuara, e që qëndrojnë nëpër trotuare.

**Florian Dushi,** drejtor tha se i kemi evidentuar disa raste, madje mbi bazën e ankesave të qytetarëve kemi pasur disa ndërhyrje në disa lagje të qytetit.

**Imer Rama,** qytetar kërkoi të dijë se si i menaxhon "Parking Prishtina", hapësirat e objekteve të reja, të cilat janë duke u ndërtuar tash e tutje.

**Florian Dushi,** drejtor tha se me rregulloren e re ne i kemi përfshirë të gjitha zonat e qytetit për menaxhimin e hapësirave publike, si dhe të mbulohen edhe objektet e reja.

**Sokol Havolli,** kryeshef tha se ne si ndërmarrje menaxhojmë me pronat komunale dhe jo me ato private.

**Jahë Balaj,** qytetar tha se po t'i referohemi rregullores së  të "Prishtina Parking", mund të konstatojmë se disa ndryshime, të cilat janë bërë në favor të Komunës dhe ndërmarrjes, pra asgjë nuk është ndryshuar në favor të qytetarit.
Rregullorja nuk guxon me qenë kundër ligjit, udhëzimi administrativ nuk guxon me qenë kundër Rregullores. Unë besojë që ju e keni një Zyre Ligjore dhe sipas kësaj rregulloreje nuk shohë së ka ndonjë zgjidhje për qytetarin e sidomos për banorët rezident.

**Osman Bllaca,** tha se kjo rregullore është në diskutim publik, ku mundeni t'i dërgoni secili komentet, sugjerimet, propozimet apo çka do që shihni në këtë draft-rregullore dhe secilën do ta trajton komisioni, i cili është për hartimin kësaj rregulloreje.

**Florian Dushi,** drejtor tha se **i**deja ka qenë që këtë rregullore ta korrigjojmë  në përputhje me vlerësimet tona që i kemi bërë dhe në përputhje me kërkesat, ankesat, vërejtjet, sugjerimet, idetë e qytetarëve dhe numrit më të madh të qytetarëve, edhe pse po, ka edhe prej tyre që kërkojnë shfuqizimin në tërësi të rregullores, dhe kthimin në gjendjen para kësaj Rregullore-je, dhe në fakt edhe ky është një propozim i ligjshëm.
Numri më i madh i kërkesave të qytetarëve janë përfshirë, por ka edhe propozime tjera të cilat janë dhënë si p.sh. që të mos paguhet për veturën e parë por të fillohet me të dytën etj. dhe sigurisht që do të trajtohen të gjitha.
Këtë rregullore e kemi gjetur në fuqi me plotë shkelje, me plotë të meta dhe po mundohemi të e korrigjojmë, sepse organizimi i parkingut në Prishtinë nënkupton edhe rregullimin dhe një mbarëvajtje më të mirë të vetë trafikut (komunikacionit) në Prishtinë.

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi** | **Kryesuesi i takimit** |
| **Arton Brahimi** | **Osman Bllaca** |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**Diskutim publik, lidhur me Projektrregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës**
**12 Prill, 2023**
**Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal**

| Nr. | Emri/Name | Mbiemri/Surname | Titulli/Title | e-mail | Nënshkrimi/Signature |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LINDITA | REXHEPI | ASAMBLEISTE | [redacted] | |
| 2 | SOKOL | HAVOLLI | PR PARKING | | |
| 3 | ARTAN | MULLARAMA | P.R - PARKING | | |
| 4 | SAMI | SALIHU | ASAMBLEIST/AKSIONAR | | |
| 5 | JAHE | BALAJ | QYTETAR | | |
| 6 | BESNIK | VITIJA | QYTETAR | | |
| 7 | Donika | Ahmetaj | Shoqëri Civile | | |
| 8 | IMER | RAMA | BANOR QENDËR | | |
| 9 | Ismajl | Jahmaj | Banor Qendër | | |
| 10 | Agnesa | Salihi | Gazetare | | |

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!*
**Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!**

| Nr. | Emri/Name | Mbiemri/Surname | Titulli/Title | e-mail | Nënshkrimi/Signature |
|---|---|---|---|---|---|
| 11 | JETA RAFUNA | HASANI | Asambleiste | | |
| 12 | Shaip Dushi | [illegible] | qytetar. | | |
| 13 | GRANIT | KRESTRESHI | [illegible] | | |
| 14 | | | | | |
| 15 | | | | | |
| 16 | | | | | |
| 17 | | | | | |
| 18 | | | | | |
| 19 | | | | | |
| 20 | | | | | |
| 21 | | | | | |
| 22 | | | | | |
| 23 | | | | | |
| 24 | | | | | |
| 25 | | | | | |
| 26 | | | | | |
| 27 | | | | | |
| 28 | | | | | |

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!*